



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina
Basic Prosecution
Departamenti për Krime të Rënda / Odeljenje za Teške Zlocine / Serious Crimes
Department



Numri i lëndës: 2022:0031900

Datë: 08.06.2026

Numri i dokumentit: 04478207

PP.I.nr.27K/26

PPN.I.nr.99K/22

PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, Prokurori i Shtetit Bashkim Zeqaj, pas shqyrtimit të kallëzimit penal të datës 06.04.2022 dhe plotësimit të kallëzimit penal të datës 15.04.2022, të paraqitur nga ankuesit Dr. Blerim Sylja dhe Dr. Xhemajl Selmani, në çështjen penale kundër të dyshuarve: [redacted], [redacted], [redacted], [redacted], [redacted] dhe [redacted], në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për Verifikimin e Kandidaturave pranë Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK), respektivisht përfaqësues të degëve regjionale të FSSHK-së, për shkak të veprave penale: Cenimi i së drejtës për të kandiduar nga neni 207, Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve nga neni 211, Manipulimi me prova nga neni 389, Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390, Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395, Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare nga neni 386, Asgjësimi i dokumenteve të votimit nga neni 217 dhe Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, **konform nenit 84 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, nxjerr këtë:**

A K T V E N D I M

I. HUDHET kallëzimi penal i parashtruar nga Dr. Blerim Sylja dhe Dr. Xhemajl Selmani, i datës 06.04.2022, si dhe plotësimi i kallëzimit penal i datës 15.04.2022, ndaj të dyshuarve:

- [redacted], në cilësinë e anëtarit dhe kryetarit të Komisionit për Verifikimin e Kandidaturave pranë Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK);



Numri i lëndës: 2022:0031900

Datë: 08.06.2026

Numri i dokumentit: 04478207

- [REDACTED] në cilësinë e anëtares së Komisionit për Verifikimin e Kandidaturave pranë Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK);
 - [REDACTED] në cilësinë e anëtares së Komisionit për Verifikimin e Kandidaturave pranë Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK);
 - [REDACTED] në cilësinë e përfaqësueses së Regjionit të Mitrovicës në Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK);
 - [REDACTED] në cilësinë e përfaqësuesit të Regjionit të Pejës në Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK);
 - [REDACTED] në cilësinë e përfaqësuesit të Regjionit të Prishtinës në Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK);
- Sepse nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se të njëjtit kanë kryer veprat penale: “Cenimi i së drejtës për të kandiduar” nga neni 207, “Keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve” nga neni 211, “Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare” nga neni 386, “Manipulimi me prova” nga neni 389, “Falsifikimi i dokumenteve” nga neni 390, “Legalizimi i përmbajtjes së rreme” nga neni 395, “Asgjësimi i dokumenteve të votimit” nga neni 217 dhe “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 414 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, apo ndonjë vepër tjetër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare.”

II. OBLIGOHET Policia e Kosovës / DHKEK – Prishtinë, që t’i fshijë të dhënat penale nga Sistemi i mbajtjes së të dhënave për të dyshuarit e lartcekur, sa i përket rastit me numër R-2023-XI-HK-HEKE-PR-185 – DHKEK-P-634-23.

Argumentimi